

DP7

25644
15.12.25

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

Ky Memorandum mirëkuptimi nënshkruhet sot, më datë 15/12/2025 dhe përcakton termat dhe bashkëpunimin midis palëve të mëposhtme:

1. **Shkolla Teknike Ekonomike Tiranë** me adrese në: Rrugën Xhorxhi Martini, Tiranë, përfaqësuar ligjërisht nga Znj. Anila Nanaj, Drejtore (më poshtë referuar si "Shkolla"),
2. Drejtoria e Përgjithshme e Tërmimeve një shoqëri _____, me seli në adresën: Rruga Gjin Buzë Shpata, përfaqësuar ligjërisht nga: _____, në cilësinë e Zv. Drejtorit të Përgjithshëm (më poshtë referuar si "Shoqëria"),

Palëve u referohemi individualisht si "Pala" dhe bashkërisht si "Palët".

1. Kuadri ligjor

Ky Memorandum bazohet në Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, dhe në ligjin nr. 15/17 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë".

2. Objekti

2.1. Ky Memorandum ka synim të shprehë vullnetin e palëve për të filluar bashkëpunimin në fushën e formimit profesional midis Shkollës dhe Shoqërisë për një ose më shumë prej formave të mëposhtme:

- **Ofrimin e skemave graduale të zhvillimit të nxënësve**; dyer të hapura në Shoqëri, histori suksesi në shkollë, punonjës si mësues/trajner në shkollë, nxënës që vëzhgojnë punonjësit gjatë punës së tyre;
- **Ofrimin e praktikës profesionale për nxënësit e shkollës** në ambientet e Shoqërisë (Apprenticeship dhe Internship) apo në distancë;
- **Ofrimin e përditësimit të njohurive për mësuesit e shkollës**;
- **Sponsorizim** në formën e kontributit për shkollën dhe/ose nxënësin;
- **Marrëdhënie e qëndrueshme me shkollën**; Shoqëria merr pjesë në aktivitetet e shkollës dhe anasjelltas;
- **Merr pjesë në vlerësimin e vazhduar dhe përfundimtar të nxënësve**;
- **Kontribuon në përmirësimin e kurrikulave apo zhvillimin e kurrikulave të reja të shkollës**;
- **Kualifikimin e mentorëve të praktikës profesionale**;
- **Regjistrimin si ofrues i formimit profesional**.
- **Literature Profesionale**

2.2. Palët do të nënshkruajnë një marrëveshje të formimit profesional e cila do të përmbajë kushtet dhe afatet e bashkëpunimit të lartpërmendur.

2.3. Në kuadër të projektit Aftësi për Punë (S4J) do të ofrohet asistencë maksimale për mirëfunksionimin e këtij memorandumi nënshkruar me vullnet të lirë të palëve.

1. Konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave personale


- 1.1. Palët marrin përsipër, gjatë dhe para diskutimeve ose lidhjes së marrëveshjes mes tyre, të ruajnë konfidencial dhe të mos përhapin asnjë informacion konfidencial që palët i kanë bërë të ditur njëra tjetrës ose që njoftohet para dhe pas diskutimeve ose lidhjes së marrëveshjes mes tyre, si dhe të mos përdorin asnjë informacion konfidencial për qëllime të ndryshme nga sa specifikohet më lart në nenin 2.
- 1.2. Palët garantojnë njëra tjetrën se punonjësit ose nënkontraktorët e tyre do të respektojnë detyrimet e konfidencialitetit të përcaktuara në këtë nen.
- 1.3. Secila nga palët i garanton palës tjetër se do të zbatojë me përpikëri detyrimet që rrjedhin prej legjislacionit në fuqi në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale

2. Të ndryshme

- 4.1. Çdo shtesë apo ndryshim i këtij Memorandumi do të kryhet me pëlqimin me shkrim të palëve nënshkruese të tij.
- 4.2. Ky Memorandum hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të tij dhe mund të zgjidhet nga secila prej palëve me njoftim paraprak me shkrim prej 30 ditësh dërguar palës apo palëve të tjera.
- 4.3. Ky Memorandum do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 4.4. Ky Memorandum nënshkruhet në 2 kopje origjinale në gjuhën shqipe, nga një për secilën palë dhe me të njëjtën përmbajtje dhe vlerë ligjore secila.

Shkolla Teknike Ekonomike Tiranë

Drejtor
Znj. Anila NANAJ



Data: ____ . ____ . 202__

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
Zv. Drejtor i Përgjithshëm i Mbështetjes së Programeve
Znj. Diana ÇARO

